



DITARI MUJOR SHKURT 2024

Kredia Studentore

Janë hapur aplikimet për kredinë studentore, e cila parashikon mbulimin e plotë të kostos së studimeve dhe të jetesës, të llogaritura deri në kufirin e pagës minimale në vend. Kredia studentore i jep mundësinë atyre studentëve që nuk përfitojnë nga bursat, mbështetjet financiare apo përjashtimet nga tarifat, të përfitojnë nga ky mekanizëm i ri i mbështetjes për studentët.



Investimet në Arsim

Ministrja e Arsimit dhe Sportit mori pjesë në inaugurimin e shkollës së mesme me orientim gjuhësor "Asim Vokshi" në Tiranë, e cila ka hapur dyert me standardet më të mira bashkëkohore. Ministrja Manastirliu inspektoi gjithashtu edhe punimet për rehabilitimin e plotë të shkollës "Kostandin Kristoforidhi" në Elbasan, "Avni Rustemi", në Tepelenë dhe "Rushen Qevani" në Selvijas të Çërrikut. 100 objektet arsimore po ndërtohen dhe rehabilitohen në të gjithë vendin.



Dy laboratorë të rinj për gjuhën e shenjave

Dy laboratorë modernë i shtohen Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Falë investimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit u hapën dy laboratorë të rinj që do t'u shërbejnë studentëve të të gjitha cikleve në procesin mësimor dhe thellimin shkencor; në zhvillimin dhe trajtimin e një kurrikule bashkëkohore të gjuhës së shenjave shqipe dhe ndërkombëtare, që do të risë ndjeshëm kapacitetet e mësuesve, përkthyesve e interpretuesve të rinj të gjuhës së shenjave.

Konkursi Kombëtar i Gjuhës Shqipe

Ministria e Arsimit dhe Sportit, në Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare, shpalli datën e fillimit të Konkursit Kombëtar të Gjuhës Shqipe për nxënësit e klasave të nënta, i cili nis më 12 mars në të gjitha shkollat e vendit. Ministrja e Arsimit dhe Sportit Ogerta Manastirliu tha se, Konkursi Kombëtar që do të ketë pjesëmarrjen e mbi 8 mijë nxënësve nga të gjitha shkollat 9-vjeçare, zhvillohet në kuadër të Vitit të Gjuhës Shqipe, të shpallur nga MAS.



Nënshkruhet marrëveshja, godina "Liria" mikpret Kolegjin e Europës në Tiranë



Hidhet një tjetër hap i rëndësishëm për të finalizuar hapjen e Kolegjit të Europës, Kampusit të Tiranës: nënshkrimi i marrëveshjes mes Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Kolegjit të Europës dhe Universitetit të Tiranës. Përmes këtij akti sigurohen hapësirat e përkohshme ku po ngrihet kampusi, që do të mikpresë 31 studentët e parë, që në shtator do të nisin vitin akademik 2024-2025, ndonëse kërkesat për të studiuar në Kampusin e Tiranës janë shumëfishe. Ky kampus do të vendoset në godinën "Liria", pranë Qytetit Studenti.

HAPET THIRRJA PËR KËRKIMIN SHKENCOR, BUXHETI 45% MË I LARTË

Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit hapën thirrjen për Projektet e Kërkimit Shkencor 2024, që synon të përfshijë të gjithë aktorët e interesuar nga universitetet, kërkuesit shkencorë si dhe bizneset. Buxheti për kërkimin shkencor, inovacionin dhe infrastrukturën këtë vit nje njëritje prej 45% dhe shtrihet në fusha të rëndësishme për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit, duke u fokusuar më së shumti te inovacioni, energjia e turizmi.



KARTA E STUDENTIT

Ministrja e Arsimit dhe Sportit Ogerta Manastirliu firmosi marrëveshjen për Kartën e Studentit me kryetarët e bashkive të Korçës, Elbasanit dhe Gjirokastrës, nga e cila do të përfitojnë studentët e këtyre universiteteve. Falë Kartës së Studentit, të rinjtë marrin shërbime me çmime të reduktuara ose falas nga entet shtetërore, në fushën e artit dhe të kulturës, të shëndetësisë dhe të mbrojtjes sociale, arsimit, sportit, transportit, turizmit, punësimit, etj.